




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Muhamet Kurtishaj 	31.05.2022	10.06.2022	Nr.171-173/22
Emri dhe Mbiemri i eks. Shqyrtues dhe nënshkrimi	Data e autorizimit të ekspertit	Data e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës:

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën. 28.05.2022 dhe 30.05.022, OE “Haxhijaha” SHPK, ka parashtruar ankesën me nr.171/22, dhe OE “Agribau” SHPK ka parashtruar ankesën me nr.173/22 kundër njoftimit për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit “Blerja e Moto kultivatorëve” me nr. prokurimi 635-22-4130-1-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues Komuna e Pejës.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, negociuar, kufizuar, lloji i kontratës: punë, furnizim, shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: : 157.500,00 €.

Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP-së,

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE të OE “Haxhijaha” SHPK

(Të përshkruhen dispozitat e shkelura dhe vetëm pikat e ankesës).

- Neni 1 i LPP-së – Qëllimi
- Neni 7 i LPP-së – Barazia ne trajtim/Jo diskriminimi
- Neni 28 i LPP-së –Specifikimet teknike

Pretendimet ankimore te parashtruara ne ankesën e deponuar ne OSHP, janë/nuk janë te njëjta.

Bazuar ne LPP, konsiderojmë qe AK ka bërë shkelje ligjore në këto nene:

Neni 1 Qëllimi.

Ne konsiderojmë qe Autoriteti kontaktues date përpilimit te dosjes se tenderit ka bere shkeljen e këtij Neni ngase dihet qe qëllimi i këtij ligji është qe te siguroj ne mënyrë efikase, me transparente dhe te drejte te shfrytëzimit te fondeve publike duke përfshirë ne çdo procedurë tenderuese sa më shumë OE duke mos krijuar kushte që shpien deri tek eliminimi apo zvogëlimi i konkurrencës ndërmjet OK.

Neni 7. Barazim ne Trajtim / Jo — Diskriminimi

a)Ne konsiderojmë qe Autoriteti Kontraktues ka bere shkeljen edhe te këtij neni përkatësisht ne Pikat 2, 3, 4, 6 ku gjate përpilimit te dosjes se tenderit përkatësisht tek Aneksi 1: Specifikimet teknike te detyrueshme — duke kërkuar disa standarde nga prodhuesi, qe nuk ka te bëjnë me cilësinë e produktit te kërkuar për furnizim ne këtë procedurë tenderuese. Natyra e kësaj kontrate është furnizim e këto standard duhen te kërkohen nga

Operatori Ekonomik të cilat do bëjnë furnizimin, ndërsa nga prodhuesi duhen të kërkohej standard që ka të bëjë me kualitetin e prodhimit si dhe testimet që këto kompani bëjnë në shtetet ku ato operojnë.

Për më tepër në Dosje të Tenderit tek Aneksi 1 kërkohej që prodhuesi të jetë i certifikuar për kualitetin IATF 16949:2016, kjo certifikata nëse shikohet në gjuhën angleze i bijën citor:

IATF — Internacional standard for Auto motive Quality Management Systemss" e që në përkthim do të thotë: Standardi ndërkombëtar për sistemet e menaxhimit të cilësisë së Automobilitave IATF është një grup prodhuesish të automobilitave që janë formuar për të

ofruar produktet cilësia për klientin e automobilitave në mbar botën. Titulli i kësaj kontrate si dhe kërkesës për furnizimi është " BLERJA E MOTOKULTIVATOREVE" e kriter vlerësues për këtë kontratë është edhe kjo certifikata/ standard e që ska të bëjë asgjë me moto kultivator. Vendosija e këtij standardi në kërkesë të AK në mënyrë automatike eliminon konkurrencën dhe ofrimin e saktë të produkteve. Përgjigja e AK në kërkesë për rishqyrtim rreth pretendimi ton: IATF16949:2016 është standard ndërkombëtar për sistemet e menaxhimit të cilësisë së mjeteve motorike, ky standard sipas AK është kërkuar për arsye të parandalimit të defekteve dhe reduktimit të prishjeve.

Arsyetimi i dhënë nga AK nuk qëndron ngase ky standard sikurse që është treguar nga ne më lart ka të bëjë me kualitetin e automobilitave (e që nuk ka asnjë lidhje me moto kultivator) dhe lehtë mundet të verifikohet nëse shikohet në internet e që saktë tregohet që është për industrinë e automobilitave "Auto motive industry" Duke parë që ky standard nuk ka

të bëjë asgjë me pajisjen të cilën autoriteti kontraktues e kërkon në këtë dosje të tenderit, në kërkojmë që ky standard të mos jetë kusht apo faktor për eliminim/shpërbllim të operatoreve ekonomik dhe në këtë mënyrë të mundësojë qasje sa më shumë të operatoreve ekonomik.

b) Autoriteti Kontraktues po ashtu kërkon edhe cert. ISO 50001:2018 e që ka të bëjë me certifikim të sistemit për menaxhim të energjisë edhe këtë certifikatë që kërkon nga prodhuesi është e pakuptimit kur dihet që moto kultivator janë me djegie motorike (diesel/benzinë) e ky standard nuk duhet të jetë kriter vlerësues ngase për Autoritetin kontraktues si dhe për përfituesin në këtë rast bujkun ky motokultivator nuk do kërkojë/shpenzojë energji elektrike apo përdorim efikas të energjisë, andaj ky standard duhet të largohet nga kriteri vlerësues, e në atë mënyrë të mundësojë qasje sa më të gjera të operatoreve ekonomike e mos të bazohet vetëm në një burim furnizues. - Përgjigja e AK në kërkesë për rishqyrtim rreth pretendimi ton: kjo certifikatë është kërkuar për të dëshmuar se pajisja është prodhuar konform ISO 50001, e cila ndihmon për të ruajtur burimet natyrore dhe ndryshimet klimatike, duke reduktuar rreziqet që lidhen me përdorimin e energjisë. Certifikimi ISO 50001 është një njohje formale e performancës së sistemit të menaxhimit të një organizate dhe demonstroi cilësinë e prodhimit. Ky standard nuk ka të bëjë asgjë në lidhje me kuantitetin dhe cilësinë e prodhimit të tyre, ky standard ka të bëjë për shpenzim dhe përdorim efikas të energjisë elektrike e për autoritetin kontraktues si dhe për fermerin/bujkun ky moto kultivator nuk do kërkojë/shpenzojë energji elektrike apo përdorim efikas të energjisë, andaj ky standard të largohet nga kriteri vlerësues, e në atë mënyrë të mundësojë qasje sa më të gjera të operatoreve ekonomike e mos të bazohet vetëm në një burim furnizues.

c) Natyra e kontratës është furnizim dhe kërkimi i certifikatave që ka të bëjë me sigurinë dhe shëndetin e punëtorëve (ISO 45001) dhe sistemi për menaxhimin e mjedisit (ISO 14001) dhe jo me kualitetin e produkteve të cilën Autoriteti Kontraktues i ka shkruar në dosje të tenderit, e ato duhen të kërkohej nga operatorët ekonomik që do bëjnë furnizimin e jo nga prodhuesi. Përgjigja e AK në kërkesë për rishqyrtim rreth pretendimi tone ISO 45001 është kërkuar për të dëshmuar se pajisja në fjalë i plotëson kushtet për mbrojtjen të shëndetit të punëtorit, përderisa plotësohen këto kushte nga prodhuesi atëherë moto kultivatori që fermerët tanë do ta përdorin është i sigurtë gjatë punës. Ky pretendim i AK nuk qëndron ngase ky standard ka të bëjë specifikisht vetëm për sigurinë dhe shëndetin e punëtorëve të kompanisë e asgjë ska të bëjë me sigurinë e ferment apo

te moto kultivatorit. Natyra e kontratës ka te beje me furnizim e ky standard duhet te kërkohet nga kompania e cila do beje furnizim e jo nga prodhuesi.

d) Natyra e kontratës është furnizim dhe kërkimi i certifikatave që ka te bëjnë me sistemi për menaxhimin e mjedisit(ISO 14001) dhe jo me kualitetin e produkteve të cilën Autoriteti Kontraktues i ka shkruar në dosje tenderit, e ato duhen te kërkohen nga operatorët ekonomik që do bëjnë furnizimin e jo nga prodhuesi.

Përgjigja e AK në kërkesë për rishqyrtim rreth pretendimi ton: ISO 14001 është kërkuar pasi që moto kultivator do përdoren në bujqësi dhe site tille në kërkojmë që te jene konform standardeve për ruajtjen e mjedisit dhe tokës bujqësore në përgjithësi.

Ky pretendim i AK nuk qëndron ngase shihet që AK nuk ka informacione rreth këtyre standardeve si lëshohen dhe për cka një kompani standardizohet për këto certifikata. ISO 14001 ka te beje me sistemin për menaxhim të mjedisit e kur një kompani aplikon për këtë standard ajo i nënshtrohet disa rregullave ose disa kushteve. Kur një kompani certifikohet me këtë standard ajo kompani plotëson kushtet për mbrojtjen e mjedisit në territorin ku ajo prodhon (ku ajo kompani bën prodhimin apo aktivitetin ekonomik) e asnjëherë kjo certifikatë ska te beje si në arsyetimin e AK për mbrojtjen e mjedisit kur këta moto kultivator do te përdoren.

Duke u bazuar në këto çështje në kërkojmë që ky kusht te largohet apo te kërkohet nga operatori ekonomik e jo nga prodhuesi.

Neni 28: Specifikimet teknike

a) Në konsiderojmë që Autoritet kontraktues ka bere shkeljen edhe te këtij neni ku gjate përpilimit të specifikave teknike ka reduktuar eliminuar konkurrencën ndërmjet operatoreve ekonomik duke vendosur specifikat teknike nga një burim ose nga një prodhues, ku edhe gjate përpilimit të specifikave teknike të tyre nuk është cekur që moto kultivator është me freze, duke mos cekur po ashtu edhe disa detajet që janë të rëndësishme në kuotim të çmimit. Si numri i thikave të frezës, gjatësia e frezës, gjerësia e frezës, thellësia e punës së frezës, trashësia e thikave të frezës, tipi i thikave, sa është pesha e frezës, freza a është me mundësi zgjerimi i ngushtimi të punës së saj, moto kultivator me çfarë djegie duhet te jete (diesel apo benzinë). Te gjitha këto kriteret janë bazik në kuotim të çmimit dhe te ofertës.

b) Autoriteti kontraktues ka here shkelje edhe te pikës 7 të këtij neni ngase ka përpiluar specifikat teknike dhe ka kërkuar standardet të cilat nuk ka te bëjnë me natyrën e kontratës si dhe disa nga standard duhen te kërkohen nga operator ekonomik e jo nga prodhuesit ku dihet që natyra e kontratës është furnizim e jo shërbim. Përgjigja e AK në kërkesë për rishqyrtim rreth pretendimi ton: kërkesa juaj hidhet poshtë si e pabazuar pasi që ju nuk keni kërkuar sqarim të specifikimeve të kërkuar por keni kërkuar që te hiqni nga specifikimet teknike, gjë që mendojmë se është e padrejte dhe mendojmë që nuk realizojmë një furnizim kualitativ. Në këtë pikë ne nuk kemi kërkuar te hiqet ndonjë nga specifikat teknike por kemi treguar që AK është bazuar vetëm nga një burim ose nga një prodhues si dhe gjate përpilimit të specifikimeve teknike nuk ka vendosur specifikat teknike apo detajet të cilat janë bazike në ofertim dhe te cilat kanë peshe madhore (si: moto kultivator që është me freze, numri thikave të frezës, pesha e frezës, motori me çfarë djegie është etj.) por ka vendosur specifikat teknike që nuk kanë asnjë peshe tek ofertimit.. Për më tepër po tek specifikat teknike ka kërkuar riga prodhuesi të ketë disa standarde që asnjëra nuk ka te bej me kualitetin e produktit apo funksionalizimin e tij.

Konkluzion:

Në kërkojmë që dosja e tenderit të rishikohet kushtet të cilat Autoriteti kontraktues i ka vendosur e që s'kanë te bëjnë asgjë me kualitetin e produktit)- të largohen si kusht për eliminim/pranim tenderimi e në këtë mënyrë mundëson qasje sa më gjere të operatoreve ekonomike.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE të OE “Agribau” SHPK

(Të përshkruhen dispozitat e shkelura dhe vetëm pikat e ankesës).

- Neni 1 i LPP-së- Qëllimi
- Neni 7 i LPP-së – Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi
- Neni 28 i LPP-së – Specifikimet teknike

Pretendimet ankimore të parashtruara në ankesën e deponuar në OSHP, janë/nuk janë të njëjta.

Me datën 24.05.2022 Agribau SHPK kemi bërë kërkesë për rishqyrtim të Specifikave të Dosjes së tenderit Blerja e Moto kultivatorëve nr.1 Prokurimit 635-22-4130-1-1-1 pran AK-së KK Peje.

Me datën 26.05.2022 AK ka marrë vendim ku ka refuzuar kërkesën tone të pa bazuar me arsyetimin se Specifikimet Teknike janë të përpiluara në përputhje me nenin 70 të LPP-së. AK me rastin e përpilimit të Dosjes së Tenderit ka bërë shkelje të hapur mbi prokurimin Publik duke vënë specifikime teknike dhe kërkesa të paarsyeshme dhe të panevojshme të cilat kërkesa ndikojnë direkt në zvogëlimin-eliminimin e konkurrencës në mes të operatorëve ekonomike e cila është çart e sanksionuar me ligjin për Prokurimin Publik.

Përpilimi i specifikimeve teknike fikse, kërkesa për prodhim evropian, kërkesat për certifikata për prodhuesin të cilat nuk kanë të bëjnë me cilësinë dhe kualitetin e pajisjes, të cilat kërkohen nga arta e AK-së janë në kundërshtim të NENI 1,7,28

Pretendimi NR.1

Kërkesa e AK-së se pajisjet e kërkuara duhet të jenë prodhim EUROPIAN bje në kundërshtim me NENI-in 28 të LPP-së paragrafi 7 ku thuhet; Autoriteti kontraktues nuk do të përpilojë specifikimet teknike që referohen një artikulli asë burimi të veçantë, ose një procesi hollësishëm ose ndonjë shenjë dalluese, citoji ose origjinë të veçantë ose ndonjë prodhimi. Prandaj AK në bazë të këtij paragrafi nuk ka të drejtë të përcaktoj origjinën e veçantë. AK në vendimin e datës 26.05.2022 nuk ka dhënë fare përgjigje apo arsye në pretendimin tone (le të hiqet nga specifikimet teknike kërkesa që pajisja të jetë prodhim Evropian.

Pretendimi nr.2

AK- ka kërkuar brenda specifikimeve teknike kërkesa të certifikatave për prodhuesin e pajisjes, certifikatat; IATF 16949: 2016, ISO 50001:2018, ISO 45001 ISO 14001. dhe në do të japin një shpjegim lidhur me këto certifikata:

1. Certificate IATE16949: 2016.

Certifikimi sipas IA IF 16949 është e detyrueshëm për organizatat që dëshirojnë të prodhojnë pjesë për industrinë e automobilave.

2. Certifikata ISO 50001:2018. Menaxhimi i sistemit energjisë.

3. ISO 45001 Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në kompani

4. ISO 14001.

Specifikon kërkesat e përgjithshme për ngritjen e një sistemi të menaxhimit mjedisor në një kompani.

Pra siç e shihet asnjëra nga këto certifikata nuk ka të bëjë asgjë me natyrën e këtij tenderi. Natyra e tenderit në fjalë është Furnizim dhe nuk është Shërbim -dhe këto certifikata nuk do të duhej të kërkohen as nga OE ofertues e kurrësi nga prodhuesi. Në këtë rast do të ishte normale të kërkohet deklarata e konformitetit CE për pajisjen a cili standard aplikohet në Kosovë në bazë të rregullores Nr.0212020 Për Sigurinë e Makinerive të Lëshuar nga MEPTIN1S.

Pretendimi nr.3

AK ka vendosur specifikime fikse si psh. Fugia 7.1 HP, 252 cm³.

Po ashtu janë vendosur specifike teknike te cilat janë te panevojshme por kane efektin e krijimit te pengesave te paarsyeshme ne hapjen e konkurrencës tne mes Operatoreve Ekonomik dhe nuk ofrojnë qasje te barabartë për tenderuesit si psh; Faktori I pasigurisë K 2,74 m/s²-3.00 m/s² sipas Dir.2006/42/ECRS

Dridhjet e moto kultivatorit (AHË) 6,5 m/s²-7.0 m/s²

Fuqia e zerit 99 al(4)-101 dB() etj.

Te gjitha këto specifika te dizajnuara ne këtë mënyrë janë te marra nga katalogu moto kultivatorit te prodhuesit ST1HL modeli MH700 te cilat janë te panevojshme dhe te përcaktohen ne dosje te tenderit por te cilat ndikojnë ne kufizimin për pjesëmarrjen e OE-ve te interesuara.

Pas gritha këtyre fakteve te ofruara shpresojmë dhe besojmë se Organi Shqyrtues i Prokurimit do ta shqyrtoj me kujdes ankesën tone dhe do ta aprovoj Si te bazuar këtë ankese duke marre:

Vendim

APROVOHET si e bazuar ankesa e OE "Agribag" SHPK kundër Vendimit te AK-se date 26,05.2022 për aktivitetin e prokurimit 3ierja e Moto kultivatorëve Nr i Prokurimit 635-22- 4130-14-1

ANULOHET njoftimi mbi Vendimin e AK-se datës 26_05.2022 dhe lënda te kthehet ne Rivlerësim ku do te përmirësohen specifikimet teknike me qellim te një pjesëmarrje te barabartë ne mes te OE-ve te interesuar për këtë tender dhe përpilimit te DT-se ne përputhje me Ligjin mbi Prokurimin Publik.

KRITERET PËR VLERËSIM

Të vendosen vetëm kërkesa/kriteret që kanë të bëjnë me arsyet e eliminimit dhe / apo ato kërkesa që lidhen me pretendimet ankimore

- Pretendimet e dy operatorëve ekonomik janë se vendosja e kërkesave në DT për ofrimin certifikatave të ndryshme janë të pa nevojshme dhe nuk kanë të bëjnë me natyrën e aktivitetit të prokurimit. Si të tilla këto certifikata duhet të largohen nga kërkesat e DT.

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

(Te përshkruhet vetëm vlerësimi i ofertës së OE ankues /ofertave, për të cilat OE ankues ka pretendime ankimore).

Ende nuk është formuar komisioni i vlerësimit të ofertave sepse aktiviteti i prokurimit është në fazën e marrjes së dosjes së tenderit.

INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK

Nuk ka marrë informacion shtesë ekspertit shqyrtues.

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

(Të jepet një vlerësim se OE ankues është apo nuk është palë me interes sipas nenit 4.1.26).

OE ankues është palë e interesit në këtë aktivitet të prokurimit.

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

(Të sqarohet nëse për rastin e njëjtë është dhënë vlerësim tjetër).

Nuk ka pasur vendim të mëparshëm për këtë aktivitet të prokurimit.

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

(Të sqarohet për rastin se pse është devijuar nga praktika e mëparshme).

Nuk kemi devijim nga praktikat e mëparshme.

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES “Haxhijaha” dhe “Agribau”

Përgjigje Pretendimin nr.1 dhe 2

Dy operatorët ekonomik ankues kanë ngritur pretendimet e njëjta se gjatë këtij aktiviteti të prokurimit AK ka bërë shkelje të neneve 1, 7 dhe 28 të LPP-së. Pretendimi i dy OE ankues është se autoriteti kontraktues në specifikimin teknik ka kërkuar certifikatat Certifikatë IATF 16949: 2016 dhe ISO 50001:2018 si dhe ISO 45001 dhe ISO 14001, certifikata këto që nuk janë të nevojshme dhe nuk kanë të bëjnë me cilësinë e produktit për këtë aktivitet dhe si të tilla ndikojnë në zvogëlimin-eliminimin e konkurrencës. Lidhur me këtë pretendim ankimor ekspertit shqyrtues ka këtë mendim.

Bazuar në dispozitat e LPP-së, respektivisht nenit 69 pika 2.5. autoritetet kontraktuese me qëllimit të sigurimit të cilësisë së produkteve, si rregull kanë të drejtë të kërkojnë certifikatave të hartuara nga institutet zyrtare për kontrollimin e cilësisë. Po ashtu bazuar edhe neni 70 të LPP-së, autoriteti kontraktues mundet të kërkon dorëzimin e certifikatave të standardeve të BE-së për sigurimin e cilësisë së produkteve. Pra në këto raste Autoriteti kontraktues do t'i pranojë certifikatat e barasvlershme të lëshuara nga cilido organ certifikues pavarësisht nga vendi, nëse organi i tillë pranohet nga një shtet anëtar i BE-së. Në pikën e specifikimit teknik të dosjes së tenderit, ku shkruan:

“Prodhim evropian te certifikuar për kualitet Certifikatë IATF 16949: 2016 dhe ISO 50001:2018”

Eksperti shqyrtues rekomandon Autoritetin kontraktues që duhet ta largoj nga kjo pikë vetëm fjalën **evropian**, që do të thotë pranohen edhe produktet e prodhuesve të tjerë të cilat i përmbajnë certifikatat e kërkuara sipas standardeve të BE-së. Mbi këtë bazë vlerësoj se pretendimet ankimore të dy operatorëve ekonomik ankues janë **pjesërisht të bazuar**.

Përgjigje Pretendimin nr.3

Lidhur me pretendimin tjetër të operatorit ekonomik ankues “Agribau” se AK ka vendosur specifikime fikse si psh. Fuçia 7.1 HP 252 cm³ po ashtu edhe parametrat tjerë si:

Faktori i pasigurisë K 2,74 m/s²-3.00 m/s² sipas Dir.2006/42/ECRS, Dridhjet e moto kultivatorit (AHW) 6,5 m/s²-7.0 m/s², Fuqia e zerit 99 dB(A)-101 dB(A) etj, të cilët janë të pa nevojshëm dhe krijojnë pengesa në hapjen e konkurrencës dhe qasjes së barabartë, ekspertit shqyrtues, ka këtë mendim.

Të gjithë parametrat teknik të produktit që janë theksuar më lartë nga OE ankues në fjalë, kanë një tolerancë prej një vlerë më të vogël deri një vlerë më të lartë dhe si të tillë japin mundësi të ofertimit më shumë tenderuesve. Përjashtimisht këtyre, vetëm parametri i fuçisë është dhënë fiks 7.1 HP për të cilin rekomandoj që duhet të **ndryshohet** nga AK dhe ti jepet një tolerancë prej një vlere më të vogël deri në një vlerë më të madhe, njëjtë si është vepruar te parametrat e tjerë. Mbi këtë bazë vlerësoj se pretendimi ankimor është **pjesërisht i bazuar**.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Në përgjithësi hartimi i dosjes së tenderit është bërë në përputhje me dispozitat e LPP-së, përjashtimisht dy rekomandimeve të theksuara më lartë të cilat munden të ngushtojnë konkurrencën. Mbi bazën e përgjigjeve të dhëna me lartë në pretendimet ankimore, ekspertit shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesat e Operatoreve Ekonomik ankues të **aprovohen pjesërisht**.

Eksperti shqyrtues në përputhje me nenin 114 pika 2 të LPP-së, rekomandon autoritetin kontraktues që të bëjë plotësim/ndryshimin e specifikacionit teknik në dy pikat e theksuara më lartë dhe të **vazhdoj** me aktivitetin e prokurimit “**Blerja e Moto kultivatorëve**” me nr. prokurimi 635-22-4130-111 në përputhje me dispozitat e LPP-së.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet: Autoritetit Kontraktues, Komuna e Pejës, Panelit Shqyrtues dhe OE ankues “Haxhijaha” dhe “Agribau”